

KONTRATË SHITJE

Sot më datë 18.12.2023 palët pjesmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme”

PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :

- **Erind Aliçkolli** shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I70402100U , lindur më Pogradec, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Shitësi)
- **Taulant Musabelliu**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I01021087U , lindur më Skrapar, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri (Shitësi)
- **Benardo Gogollari**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi J00209030M , lindur më Tepelene, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Blerësi)

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave zotëruese nga Erind Aliçkolli dhe Taulant Musabelliu te cilet përfaqësojnë 77.5 % të kapitalit të shoqërisë “Tok Digital Agency ose nga 38.75 secili me numër unik (NUIS) L62126009T, me adresë Tirane Tirane Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Kati 6, Hyrja 14, 1019 Tirane.

- Shitjen e kuotës zotëruese nga nga Erind Aliçkolli dhe Taulant Musabelliu 5% të kapitalit të shoqërisë, Tok Digital Agency ose nga 2.5% secili kalojn te Benardo Gogollari 5% te kuotave.

Neni 2

Cmimi

Cmimi i shitjes së 1 (një) kuote e cila përfaqëson 5% të kapitali të shoqërisë “Tok Digital Agency” është 350 000 lek .

Neni 3

Afati i pagimit te cmimit

Pagimi i cmimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e shitesit

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e cmimit ne mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzoje blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet te garantoje bleresin per gezimin e qetë te kuotave nga cdo e drejtë pronësie të personave të trete. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nese ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve te personave te trete, mbi kuotat objekt i kontrates.

Neni 5

Te drejtat dhe detyrat e bleresit

1. Bleresi ka të drejtë te kërkojë dokumentat qe vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitesi nga e nesermja e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.
2. Bleresi eshte i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria ka qëndrën e ushtrimit të aktivitetit

Neni 6

Zgjidhja e kontratës

1. Shitesi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhe kontraten kur:

- a) blerësi nuk paguan cmimin.



b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;

c)blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave

2.Blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur:

a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave

b)shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtese 10 ditor, te caktuar nga blerësi ;

b) shitesi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do te dorezojë dokumentacioni dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit;

Neni 7

Pasoja e zgjidhjes se kontrates

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjykatës së "Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Neni 9

Shpenzimet per lidhjen e kontratës

Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen te dyja palëve përkatësisht.

Neni 10

Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuotat zotëruese të ortakeve Erind Aliçkollli dhe Taulant Musabelliu shoqërinë "Tok Digital Agency" Shpk 5 % ne total ose 2.5% e secilit në datën 18.12.2023 kalojnë në pronësi të, Benardo Gogollari me vlere 350 000 leke., Kjo kontratë hyn në fuqi në datën 18.12.2023

Neni 11

Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në 2 (dy)kopje nga një për secilën palë.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSIT :

Taulant Musabelliu

Erind Aliçkollli

BLERESI :

Benardo Gogollari

Benardo Gogollari

Erind Aliçkollli

E

Benardo Gogollari